

## ÇËSHTJE GJYQËSORE

### Të drejtat në punë

**Kryetarit të Sindikatës në call center i njihet nga gjykata e drejta e shpërblimit me 6 paga kundër punëdhënësit për zgjidhjen e kontratës së punës.**

Datë 20/05/2024 - Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka pranuar padinë e punëmarrësit të përfaqësuar nga Centre for Legal Empowerment për zgjidhjen e kontratës së punës nga punëdhënësi në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme.

Punëmarrësi ishte zgjedhur Kryetar i Sindikatës Kombëtare të Operatorëve Telefonikë pranë punëdhënësit i cili e ushtron veprimtarinë në sektorin e call centre dhe zgjidhja e kontratës së punës pa pëlqimin e Sindikate është e konsideruar e pavlefshme. Për rrjedhojë, gjykata i njohu punëmarrësit të drejtën e shpërblimit me 6 paga mujore. Gjykata rrëzoi pretendimet e përfaqësuesit ligjor të kompanisë call centre sipas të cilave punëdhënësi nuk duhet të merrte pëlqimin e Sindikatës për zgjidhjen e kontratës dhe që Kryetari i saj nuk gëzon mbrojtje në ushtrimin e të drejtave sindakale, për sa kohë palët nuk kishin lidhur një kontratë kolektive.

Ky proces gjyqësor është ndjekur nga avokatët e Centre for Legal Empowerment që prej vitit 2021 dhe për rreth 3 vjet është ofruar ndihmë ligjore nëpërmjet këshillimit ligjor, hartimit të kërkesëpadisë dhe përfaqësimit në gjykatë.